

VENDIM
Nr. 111, datë 15.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 85 HA, NË OBJEKTIN "GJINAJ", TË QARKUT TË KUKËSIT, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "INFO METAL PLAST-AL", SH.P.K. PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË NIKELIT SILIKAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 85 ha, pjesë e ngastrave nr.103a, 117, 118, 119, 122, 123, 129a, 131, 157, 160, 161 dhe 164, në objektin "Gjinaj", të ekonomisë pyjore "Tej Drini i Bardhë", të qarkut të Kukësit, që do të përdoret nga shoqëria "Info Metal Plast-Al", sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të nikelit silikat, të hiqet nga fondi pyjor e kullor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullorore në sipërfaqen objekt mineral paguhen nga shoqëria "Info Metal Plast-Al", sh.p.k., në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "Info Metal Plast-Al", sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim sipas kushteve të lejeve mjedisore dhe, brenda 5 viteve, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 97 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqja pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore" dhe e regjistron në kategorinë "Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet mineral".

6. Me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria "Info Metal Plast-Al", sh.p.k., të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria "Info Metal Plast-Al", sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NGA SHOQËRIA "INFO METAL PLAST-AL" sh.p.k. në qarkun e KUKËSIT

QARKU Kukës				Lidhja 1	
<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullorore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Përdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
KU 39	Tej Drini i Bardhë	103a	cungishte	Ministria Mjedisit	3
KU 39	Tej Drini i Bardhë	117	cungishte	Ministria Mjedisit	7
KU 39	Tej Drini i Bardhë	118	cungishte	njqv Gjinaj	4
KU 39	Tej Drini i Bardhë	119	cungishte	njqv Gjinaj	6
KU 39	Tej Drini i Bardhë	122	cungishte	njqv Gjinaj	5
KU 39	Tej Drini i Bardhë	123	cungishte	njqv Gjinaj	3.5
KU 39	Tej Drini i Bardhë	129a	cungishte	njqv Gjinaj	7.5
KU 39	Tej Drini i Bardhë	131	shkurre	njqv Gjinaj	15
KU 39	Tej Drini i Bardhë	157	trungishte	njqv Gjinaj	6
KU 39	Tej Drini i Bardhë	160	shkurre	njqv Gjinaj	9
KU 39	Tej Drini i Bardhë	161	shkurre	njqv Gjinaj	16
KU 39	Tej Drini i Bardhë	164	shkurre	Ministria Mjedisit	3
GJITHSEJ					85.00

K-34-65-D-b
EKONOMIA PYJORE TEJ DRINI I BARDHE
SUBJEKTI "Info Metal Plast-AL" Sh.p.k
OBJEKTI "GJINAJ-DOMAJ", RRETHI HAS

SH 1:25000



